

STATUT I SHOQËRISË “DONE Marketing” SH.P.K.

Ky statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Statutin e Themelimit të Shoqërisë, organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

Kompania dhe ortakët nuk mund të bëjnë investime në para, në natyrë apo në mënyra të tjera pa miratimin, pëlqimin dhe prezencën e ortakëve themelues të Shoqërisë.

KAPITULLI I.

THEMELIMI, EMRI DHE THEMELUESIT

Neni 1

Themelimi, Forma dhe Ortakët

Sot me datë **09.09.2025**, Une themeluesi **Z.ERION HASMETA**, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “**DONE Marketing**” SH.P.K.

Themeluesi i shoqërisë është:

- **Z.ERION HASMETA**, shtetas shqiptar, lindur në Bulqizë, më 13.07.2000, mbajtës i kartës së identitetit nr. K00713058L.

Në përputhje me Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” dhe me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, miratoi këtë Statut si vijon:

Në këtë Statut:

- “Ligji” është Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- “Statuti” është ky Statuti i Shoqërisë.

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Sherbime Marketing, mbajtje e sistemeve, Furnizimi i website-ve, web-hosting, mirëmbajtjes në distancë të programeve dhe pajisjeve, furnizimi me software dhe përditësimi i tyre, furnizimi i imazheve, teksteve dhe informacioneve dhe vlefshmëria e bazës të të dhënave (database).

Neni 3

Objekti i Shoqërisë.

Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të Shoqërisë.

Neni 4

Selia

4.1 Selia e Shoqërisë është Bashkia TIRANE, Njesia Bashkiake nr.10, Rruga Durrësit, ND. 204, Shkalla 8, Apartamenti B.

4.2 Transferimi i Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendim të Asamblesë, së Përgjithshme të Ortakëve.

4.3 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si dhe jashtë saj.

Neni 5

Kohëzgjatja e veprimtarisë.

5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë për një periudhë të pakufizuar.

5.2 Shoqëria mund të prishet në çdo kohë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA E KUOTAVE TË KAPITALIT

Neni 6

Kapitali themeltar.

6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 200.000(dyqind mije) lekë.

6.2 Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërise është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtëme:

1. Ortaku themelues është **Z. ERION HASMETA**: Zotëruese i 1(një) kuote me vlerë të përgjithshme 200.000(dyqind mije) lekë që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Derdhja Kapitalit

Derdhja e kapitalit do të kryhet pas rregjistrimit të Shoqërisë në rregjistrin tregtar, gjatë fazës së zhvillimit të aktivitetit të Shoqërisë.

Neni 8

Rritja e kapitalit themeltar.

8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve që përfaqësojnë % e kapitalit të shoqërisë.

8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, kuotat e ortakëve të shoqërisë do të rriten sipas shumave të përcaktuara në vendimin e asamblesë së përgjithshme të ortakëve.

Neni 9- Zvogëlimi i kapitalit themeltar.

9.1 Shoqëria mund të zvogelojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuara nga ligji.

9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve sipas shumave të përcaktuara në vendimin e asamblesë.



Neni 10- Transferimi i kuotave të kapitalit dhe e drejta e parablerjes.

10.1. Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve sipas nenit 73 të ligjit 9901, date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

10.2 Në rast transferimi të kuotave të kapitalit në çdo lloj forme personave të tretë, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim, me çdo kusht, duke përfshirë edhe dhurimin e kuotave, ortakët e tjerë gëzojnë të drejtën e parablerjes mbi këto kuota kapitali.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL.

Neni 11

Asambleja e ortakëve.

11.1 Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Pergjithshme e Ortakëve.

11.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i pjesëve të kapitalit që zotëron.

11.3 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër ortak, i pajisur me procurë me shkrim, me anë të së cilës mund të japë votën e tij.

11.4 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, nëqoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

11.5 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve ose nga një ose disa ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5%(pesë përqind) të kapitalit themeltar. Në çdo rast, Asambleja thirret të paktën një herë në vit, jo më vonë se fundi i muajit të Qershorit për të diskutuar, vlerësuar dhe miratuar bilancin e vitit të fundit financiar.

11.6 Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve të paktën 7(shtatë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të mbaj informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat duhet të merret vendimi mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.

11.7 Asambleja do të quhet rregullisht e mbledhur edhe nëse formalitetet e thirrjes nuk respektohen, nëse ortakët që përfaqësojnë kapitalin e plotë janë të pranishëm apo të përfaqësuar dhe janë dakord të mbajnë mbledhjen edhe formalitetet e lartpërmendura nuk janë respektuar.

11.8 Çdo Asamble drejtohet nga Kryetari i emëruar ndërmjet ortakëve ose personave të tretë. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo ortak, në se prania e noterit nuk është e nevojshme.

11.9 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë saj. Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe video konferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe ti lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të argumenteve; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.

Neni 12

Kuorumi dhe kompetencat e Asamblesë.

12.1 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, të cilat merren me shumicë të zakonshme, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakë me të drejtë vote që përfaqësojnë me shumë e 51% të kapitalit. Në rast mungese të këtij kuorumi në mbledhjen e parë, Asambleja thirret në mbledhjen e dytë me të njëjtin rend dite jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pas mbledhjes së parë.

Asambleja e Zakonshme merr vendime me shumicën e thjeshtë të ortakëve të pranishëm të përfaqësuar.

12.2 Vendimet e Asamblesë Përgjithshme, të cilat merren me shumicë të kualifikuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që përfaqësojnë me shumë se 71% të kapitalit. Në rast mungese të këtij kuorumi në mbledhjen e parë Asambleja thirret në mbledhjen e dytë me të njëjtin rend dite jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pas mbledhjes së parë. Asambleja e Jashtëzakonshme merr vendime me shumicën e kualifikuar % të ortakëve të pranishëm apo të përfaqësuar.

12.3 Asambleja e Përgjithshme merr vendime me shumicë të kualifikuar % të ortakëve të pranishëm për ndryshimet e statutit, rritjen apo zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe shkrirjen e shoqërisë dhe të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj nga ky statut.



Neni 13- Administrimi.

13.1 Shoqëria administrohet nga 1(një) administrator i cili qëndron në detyrë deri në revokimin apo dorëheqjen, për një periudhë prej **5(pesë)vjet** me të drejtë rizgjedhjeje nga Asambleja për të njejtën periudhë.

13.2 Administratori/ët mund të ndërmarrin të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë, me përjashtim të atyre që ju rezervohen organeve të tjera të shoqërisë nga ky statut apo ligji i zbatueshëm.

13.3 Përfaqesimi ligjor i Shoqërise i përket Administratorit/ve të cilët janë: **Z.ERION HASMETA, shtetas shqiptar, lindur më 13.07.2000 ne Bulqizë, Shqipëri, madhor dhe me zotesi per te vepruar, me ID nr. K00713058L.**

13.4 Admmistratori/ët mund të emërojë/në përfaqësues të posaçëm për akte të veçanta ose për kategori aktesh.

Neni 14-Eksperti kontabël i autorizuar.

14.1 Në rast se përcaktohet nga ligji apo kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ekspert kontabël të autorizuar.

14.2 Eksperti kontabël i autorizuar do të emërohet për 1(një) vit ushtrimor financiar dhe do të mbarojë mandatin e tij në datën e asamblesë së mbledhur për miratimin e bilancit të vitit të kaluar ushtrimor, me të drejtë rizgjedhje.

14.3 Eksperti kontabël i miratuar mund të revokohet sipas normave të legjislacionit në fuqi.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 15

Viti financiar dhe bilanci vjetor.

15.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor të secilit vit.

15.2 Viti i parë ushtrimor fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë pranë Oëndrës Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon në 31 dhjetor të atij viti.

15.3 Bilanci vjetor, inventari, relacioni i Administratorit/ve dhe eventualisht i ekspertit kontabël (nëse është emëruar) do të miratohen nga Asambleja sipas shumicës së përcaktuar në ligjin 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".



15.4 Miratimi i dokumenteve që kanë të bëjnë me vitin ushtrimor do të bëhet brenda 6 muajve nga data e mbarimit të vitit ushtrimor.

Neni 16

Fitimet.

16.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci duke zbritur 5%(pesëpërqind)për rezerva ligjore deri në arritjen 10%(dhjetë përqind] të kapitalit si dhe shumat e tjera që mund të lenë mënjanë Asambleja me vendim, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.

16.2 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor te rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo edhe shtyrjen e shpërndarjes së Fitimeve , plotësisht ose pjesërisht, për vitet e tjera financiare.

KAPITULLI V

SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI SHOQËRISË

Neni 17

Prishja.

17.1 Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e paparashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.

17.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, pazotësisë juridike, vdekjes ose falimentimit të ortakëve.

Neni 18

Likuidimi.

18.1 Në rast prishjeje, Shoqëria duhet të likuidohet.

18.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose me shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjëndjen e aktivitetit dhe pasivit të bilancit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.

18.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

18.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit të ortakëve, në proporcion me kuotat e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 19

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve.

19.1 Të gjitha mosmarrëveshjet midis palëve që mund të lindin ose lidhen me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti dhe Akti të Themellimit si dhe në përgjithësi çdo mosmarrëveshje që mund të lind mes ortakëve (përveç mosmarrëveshjeve që kanë të bëjnë me raporte personale dhe nuk lidhen me shoqërinë), ose midis disa ortakëve me shoqërinë do të zgjidhen me mirëkuptim midis palëve me diskutim të drejtpërdrejtë të të interesuarve

19.2 Nëse nuk arrihet që një mosmarrëveshje të zgjidhet me mirëkuptim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Neni 20- Gjuha

20.1 Ky Statut nënshkruhet në 2(dy) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"DONE Marketing" SH.P.K.

ERION HASMETA

Erion Hasmeta
